

NJOFTIM

Enti Rregullator i Energjisë, nën kryesimin e Kryetarit z.Petrit Ahmeti, anëtarëve të Bordit si dhe Drejtuesve të strukturave kryesore, mirëpriti sot në ambjentet e ERE, Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kryesi të z. Ferat Shala.

Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e të dy palëve diskutuan rreth nismave ligjore që do të ndihmonin në përafrimin e akteve të rregullimit të sektorëve të energjise elektrike dhe gazit të Shqipërisë dhe Kosovës duke patur në fokus fushat e veprimtarisë dhe të bashkëpunimit mes dy vendeve si dhe dy institucioneve përkatëse.

Duke patur parasysh se në Tetor të vitit 2020 u themelua Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX), në bashkëpronësi të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe Kosovës (KOSTT),



përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar të Kosovës, kërkuan të informohen më gjerësisht e nga afër në lidhje me rregullimin e sektorit energjistik në Shqipëri, duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm vendosjen e bashkëpunimit reciprok mes dy vendeve, veçanërisht në kushtet e krizës energjitike që ka prekur vendet tona dhe të rajonit.

Zoti Ahmeti, mes të tjerave, në fjalën e tij prezantoi para përfaqësuesve të Komisionit Parlamentar të Kosovës, punën e bërë në Shqipëri nga Rregullatori, më fokus të veçantë në përmbushjen e objektivave të paketës së tretë legislative në fushën e energjisë elektrike ku Shqipëria dhe Kosova janë angazhuar të krijojnë bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (DAM) dhe brenda së njëjtës ditë (IDM) në një treg rajonal.

Kryetari i ERE, bëri po ashtu bëri me dije në lidhje me memorandumit dhe Kontratën Kornizë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike për ditën në avancë të nënshkruar mes operatorëve të sistemeve të transmetimit OST, KOSTT, si dhe Enteve Rregullatore ERE dhe ZRRE.

Zoti Ahmeti, informoi përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar të Kosovës, se me regullatorin e Kosovës dhe TSO-të janë ngritur grupet e përbashkëta të punës për ndjekjen e ecurisë së operimit të Bursës si dhe ndërmarrjen e hapave të metejshëm regullatorë për lehtësimin e bashkimit të tregjeve.

Nga ana e përfaqësuesve të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kryesi të z. Ferit Shala, u kërkua rritja e bashkëpunimit mes dy vendeve, sa i përket jo vetëm eksperiencës së Shqipërisë por edhe ekspertizës së teknikienëve shqipëtare të sektorit energjitik dhe atij të gazit, me qëllim çuarjen përpara të projekteve madhore e të përbashkëta të të dy vendeve që do të ndihmojnë në të ardhmen në rritjen e efikasitetit të dy tregjeve dhe minimizimin e impaktit të krizave globale potenciale.

Anëtarja e Komisionit Parlamentar të Kosovës, znj.Mimoza Kusari Lila, vuri theksin në nevojën për funksionimin komplementar të tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës, nisur nga natyra e burimeve të energjisë të shfrytëzuara për prodhimin vendas si dhe nevojat e alternuara për energji të dy vendeve tona. Hedhja e urave solide të bashkëpunimit në këtë aspekt u pa nga të dy palët në këtë takim, si një hap i domosdoshëm i së ardhmes për të cilin duhet të punojnë të dy vendet.

Komisionerja e Bordit të ERE Znj.Sadushi, i njohu përfaqësuesit e Parlamentit të Kosovës me rregullimin që Shqipëria ka bërë për kategori të veçanta të prodhuesve sic janë vetëprodhuesit, si dhe shpjegoi hallkat institucionale ndër të cilat kalon procesi i njohjes së të drejtës së ushtrimit të aktivitetit të prodhimit të energjisë, i cili në Shqipëri finalizohet me licensimin nga ana e Rregullatorit si dhe mbikëqyrjen e aktivitetit prodhues nga ky institucion.

Një interes të veçantë për përfaqësuesit e Kosovës, pati edhe prezantimi që, Komisioneri i ERE, Z.Shuli, i bëri hapave që Shqipëria ka ndërmarrë vitet e fundit, me qëllim krijimin e klimës ligjore dhe administrative që në të ardhmen do t'i garantojë Shqipërisë krijimin e një tregu gazi funksional.